



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTTRRI

Numri i lëndës: 2025:013873

Datë: 27.03.2025

Numri i dokumentit: 07056381

P.nr.82/2025

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTTRRI - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Naim Rekalju, me zyrtaren ligjore Arta Jusufi, në çështjen penale kundër të pandehurit I.K nga fshati ..., komuna e Vushtrrisë, të cilin sipas detyrës zyrtare e mbron av. Namon Merovci, për shkak të veprës penale *Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve* nga neni 366 par.1 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, PP.II.nr.57/2025 të datës 03.03.2025, pas mbajtjes së seancës dëgjimore për shqyrtimin e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë me datën 17.03.2025, në praninë e prokurorit të shtetit Shaqir Sedolli, të pandehurit dhe mbrojtësit të tij, në të njëjtën ditë mori dhe shpalli, ndërsa me datë 27.03.2025 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I PANDEHURI: I.K, nga i ati B..., e ëma Z..., e vajzërisë K..., i lindur më ..., në fshatin ..., komuna e Podujevës, tani me vendbanim në fshatin ..., rr. "...", komuna e Vushtrrisë, me numër personal ..., profesor i gjuhës gjermane, i martuar, prind i dy fëmijëve, ka të kryer fakultetin e gjuhës gjermane, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, më parë i pa gjykuar.

ËSHTË FAJTOR

SEPSE: Më datë 31.12.2024, rreth orës 02:08, në afërsi të ..., gjegjësisht në fshatin ... të Komunës së Vushtrrisë, në kundërshtim me Ligjin Nr.05/L-022 për Armë, ka mbajtur armën në posedim të paautorizuar, në atë mënyrë që, deri sa i njëjti ka qenë në shëtitje në këmbë, është ndaluar nga zyrtarët policor dhe gjatë kontrollimit, i është gjetur një pistoletë e llojit "Beretta" me kalibër 9x19 mm, me numër serik A040447X, me një karikator, në të kishte pasur të mbushur 13

(trembëdhjetë) fishek me mbishkrim MKE21 9P dhe të njëjtit i është sekuestruar arma e lartcekur si dhe leja e armës për shenjëtari me numër serik BD1910230053416.

Me këtë ka kryer veprën penale *Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve* nga neni 366 paragrafi 1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata konform dispozitave të neneve 4, 7, 17, 38, 39, 40, 43, 69, 70, 71 dhe 72 të KPRK-së, si dhe nenit 230, 241, 242, 269, 276, 364, 449 dhe 450 të KPPK-së,

G J Y K O N

I. ME DËNIM ME GJOBË në shumën prej 600€ (gjashtëqind euro), i cili dënim duhet të paguhet në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në rast se i pandehuri refuzon të paguaj dënimin me gjobë, atëherë ky dënim me gjobë do të shndërrohet në dënim me burg, duke i caktuar të pandehurit për çdo njëzetë (20) euro të dënimit me gjobë, nga një (1) ditë burgim.

II. Konfiskohet arma e zjarrit e markës “Beretta” me kalibër 9x19 mm, me numër serik A040447X, me një karikator, dhe 13 (trembëdhjetë) fishek me mbishkrim MKE21 9P, si dhe leja e armës për shenjëtari me numër serik BD1910230053416.

III. DETYROHET i pandehuri që në emër të kompensimit të viktimave të krimit të paguajë shumën prej njëzetë euro (20€), si dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej tridhjetë euro (30€), të gjitha këto në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzë PP.II.nr.57/2025 të datës 03.03.2025, kundër të pandehurit I.K nga fshati ..., komuna e Vushtrrisë, për shkak të veprës penale *Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve* nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm, së bashku me aktakuzën e lartcekur kanë dorëzuar edhe Marrëveshjen për Pranimin të Fajësisë PP.II.nr.57/2025 të datës 27.02.2025, të lidhur në mes të akuzuarit I.K dhe prokurorit të shtetit pranë Prokurorisë Themelore në Mitrovicë.

Gjykata ka caktuar shqyrtimin fillestar – seancën dëgjimore për shqyrtimin e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë me datën 17.03.2025, ku në pajtim me dispozitat e nenit 230 të KPRK-së, ka shqyrtuar marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë, ku ka dëgjuar prokurorin e shtetit Shaqir Sedolli, të akuzuarin I.K, si dhe mbrojtësin sipas detyrës zyrtare av. Namon Merovci.

Prokurori i Shtetit në shqyrtimin fillestar - seancën dëgjimore për shqyrtimin e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë ka deklaruar se marrëveshja mbi pranimin e fajësisë është e ligjshme dhe e lidhur me vullnetin e palëve, duke u bazuar në dispozitat e KPRK-së, andaj gjykatës i ka propozuar që marrëveshjen e arritur së bashku me dënimin e merituar ta aprovojë në tërësi.

Mbrojtësi i të pandehurit, av. Namon Merovci në shqyrtimin fillestar - seancën dëgjimore për shqyrtimin e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë ka kërkuar nga gjykata që të aprovohet marrëveshja mbi pranimin e fajësisë.

I pandehuri në shqyrtimit fillestar - seancën dëgjimore për shqyrtimin e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë ka deklaruar se e përkrah në tërësi deklarin e mbrojtësit të tij.

Gjykata pas shqyrtimit të marrëveshjes për pranimin e fajësisë të paraqitur nga Prokuroria Themelore – Departamenti i Përgjithshëm në Mitrovicë me numër PP.II.nr.57/2025 të datës 27.02.2025, sa i përket të akuzuarit I.K, për shkak të veprës penale *Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim i paautorizuar të armëve* nga neni 366 par.1 të KPRK-së, si dhe deklarin për pranimin e fajësisë të bërë nga i akuzuari në pajtim me dispozitat e nenit 230 par.18 të KPRK-së, gjykata ka gjetur se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë dhe pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë të vullnetshme.

Prokurori i shtetit pasi është ftuar nga gjykata që të paraqesë pikëpamjet e tij, ka deklaruar se pas aprovimit të marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë nga ana e gjykatës, në tërësi është vërtetuar gjendja faktike e përshkruar si në dispozitiv të aktakuzës, andaj gjykatës i ka propozuar që të pandehurin ta shpallë fajtorë dhe të njëjtin ta dënojë sipas dënimin të përcaktuar në marrëveshje mbi pranimin e fajësisë, po ashtu gjykata të ketë parasysh rrethanat lehtësuese dhe rënduese dhe atë si rrethanë rënduese të merr parasysh faktin se kemi të bëjmë me një vepër penale e cila paraqet rrezikshmëri të lartë shoqërore, faktin se i njëjti armën e ka mbajtur në vend publik dhe atë duke u shëtitur në këmbë me armë, po ashtu i njëjti përveç armës ka pasur edhe 13 fishekë, ndërsa rrethana lehtësuese pranimin e gjendjes faktike, po ashtu faktin se i pandehuri nuk ka të kaluar kriminale.

Mbrojtësi i të pandehurit, av. Namon Merovci ka deklaruar se i mbrojturi i tij armën për të cilën është akuzuar, ka poseduar një leje, dhe nga një pakujdesi, frikë nga qentë endacakë e ka marrë me vete, duke shtuar se gjykata në rast se i vlerëson të gjitha rrethanat do të gjejë se i mbrojturi i tij gëzon lehtësime të mëdha lidhur me këtë vepër, dhe atë faktin se i njëjti nuk ka rënë më parë ndesh me ligjin, punon dhe është i arsimuar.

I pandehuri I.K ka deklaruar se fillimisht kërkon falje sepse nuk ka dashur të vie puna deri këtu, por kur ka qenë i vogël e kanë kafshuar qentë dhe se ka fobi nga ta, dhe armën e ka marrë në vetëmbrojtje, ka shtuar se kërkon falje sepse nuk është dashur të ndodh kjo dhe se armën e ka mbajtur vetëm nga frika.

Gjithashtu gjykata ka konstatuar se në shkresat e lëndës ka prova të mjaftueshme që vërtetojnë faktin se i akuzuari ka kryer veprën penale me të cilën ngarkohet me aktakuzë dhe atë duke u bazuar në pranimin e fajësisë nga vet i akuzuari dhe marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë, si dhe në provat tjera të cilat i përmban aktakuza, e të cilat prova janë të mjaftueshme për të vërtetuar se i akuzuari ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë, ku gjithashtu gjykata ka konstatuar se në shkresat e lëndës nuk ekziston asnjë rrethanë e paraparë me nenin 248 par.1 dhe 2 të KPPRK-së për pushimin e procedurës, përkatësisht hudhjen e aktakuzës, prandaj gjykata ka konstatuar se marrëveshja mbi pranimin e fajësisë ka mbështetje ligjore dhe bazuar në nenin 230 par.21 të KPPRK-së të njëjtën e ka pranuar dhe ka vendosur në shkresat e lëndës.

Prandaj, gjykata nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale të përshkruar si në shqiptim të këtij aktgjykimi, duke gjetur se me të vërtetë i akuzuari ka kryer veprën penale ashtu siç përshkruhen në aktakuzë dhe në marrëveshjen për pranimin e fajësisë dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin të shpall fajtor dhe të gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij, ashtu që për këtë vepër penale është paraparë dënimi me burgim ose dënim me gjobë, ku sipas marrëveshjes, gjykata i shqiptoj dënim me gjobë në shumën prej gjashtëqind (600) euro.

Me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit, gjykata i vlerësoi të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, të cilat konform nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit e të cilat janë me ndikim me rastin e dënimit. Ashtu që për të akuzuarin, si rrethana lehtësuese gjeti pranimin e fajësisë sipas marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë, kërkim faljen dhe se armën e ka mbajtur nga frika. Ndërsa si rrethana rënduese gjykata gjeti shkallën e përgjegjësisë penale, si dhe intensitetin e rrezikimit të vlerës së mbrojtur.

Gjykata, duke vlerësuar të gjitha këto rrethana ka gjetur se me këtë dënim të shqiptuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38 KPRK-së dhe se ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën e kryer penale dhe me rrethanat personale të të akuzuarit.

Arsyet lidhur me konfiskimin e armës, shpenzimet e procedurës dhe kompensimin e viktimave të krimit.

Vendimin lidhur me konfiskimin e armës, gjykata e ka marrë në bazë të nenit 269 par.1 KPPK-së e në lidhje me nenin 276 KPPRK-së, pasi që gjykata ka vërtetuar se i akuzuari nuk posedonte leje, e as autorizim për përdorimin e armës.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e ka marrë në bazë të nenit 449 par 2 nën par 2.6 dhe nenit 450 par. 1 të KPPK-së.

Vendimin për taksën e kompensimit të viktimave të krimit gjykata e ka marrë në bazë të nenit 6 paragrafi 1 pika 1.5 dhe nenin 39 par 3 pika 3.1 të Ligjit Nr. 05/L-36 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Andaj, gjykata duke u bazuar në arsyet e lartshënuara ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal

P.nr.82/2025, datë 27.03.2025

Zyrtarja Ligjore

Arta Jusufi

G j y q t a r i

Naim Rekalii

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Kosovë, në afat prej tridhjetë (30) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të aktgjykimit. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe për gjykatën.